



SHËRBES' E BEKIMIT TË VOGËL TË UJIT

PRIFTI nis :

E bekuar është Perëndia jonë për gjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Mbret qiellor, Ngushëllimtar, Shpirt' i së vërtetës, që ndodhesh kudo dhe mbush të gjitha, thesar' i të mirave dhe falësi i jetës, eja dhe tendësô nër ne dhe spastrô-na prej ç' dô pikle.

Shënt Perëndi...

Trinî e Tërëshëntë...

Ati ynë...

Se jotja është mbretëria...

Pastaj Psalmi 143 : « O Zot, dëgjô të folurit t' im ». — Shëkô nër 6 Psalmet. Pastaj :

Perëndia është Zoti dhe u-çfaq nër ne ; i bekuar është ay që vien më emërin e Zotit. (4 herë.)

Dhe thohen këtë Tropole :

TINGËLL IV.

Hyjlindëses le t' i rendim pranë tanî me gjithë zëmër ne mëkatarët, e të përunjur le t' i biem nër këmbë, duke thirrur me pendim thellazi prej shpirtit : O Zonjë, ndihmô-na, e dhëmpshëroh-u për ne ; shpejtô, se humbasim prej shumice fajesh. Mos i

kthë prapë shërbëtorët e tû të zbrazët ; se ty të kemi të vetëmën shpresë.

Lavdi ; Tanî.

Nuk do t' pushojmë kurrë, ô Hyjlindëse, së foluri për fuqit' e tua ne të pavyerit ; se, po të mos na mpronje ti, duke nërmjetuar, kush do t' na shpëtonte prej kaqë rezikësh ; dhe cili do t' na ruante gjer më tanî të lirë ? Nuk do t' largohemi prej teje, ô Zonjë ; se ti shpëton përherë shërbëtorët e tû prej çfarëdo tmerresh.

Pastaj Psalm 51.

Përdëllyes, përdëllë-më, ô Perëndî...

(Shëkô në Mëngjes.)

Pastaj këndohen Troparet e Kanunit.

Pasandaj PRIFTI :

Se i Shëntë je, ô Perëndia jonë, dhe ty të dërgojmë lavdi, Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Tropare. TINGËLL TËRTHOR II.

Tanî erdhi koha që i shëntëron të gjithë, dhe na pret Gjykatësi i drejtë ; po ktheh-u, ô shpirt, më pendim, si e Përdalmja që thërriste me lot : O Zot, mëshirô-më.

Duke derdhur si shi me lumënj burimin e shëri-meve, ô Krisht, te Kisha e nderuar e Virgjëreshës sot, ndoqe sëmurdjet e të sëmurëve me spërkatjen e bekimit tënt, ô mieku i shpirteve dhe i trupeve tona.

Virgjëreshë linde e pamarrtuar, Virgjëreshë mbete, ô Nën' e panusëruar, Hyjlindëse Marî ; lutni Krishtit Perëndisë s' onë të na shpëtojë.

Hyjlindëse Virgjëreshë e Tërëshëntë, drejtësoj-i veprat e duarve tona, dhe lyp ndiesën e fajeve tona, taní që pô këndojmë hymnin e Engjëjve.

Shënt Perëndi, Shënt i Fuqishmë, Shënt i Pavdekur, mëshirô-na... etj.

APOSTULLI.

Zoti është ndriçimi im dhe Shpëtimtari im. Zoti është mprojtësi i jetës s' ime.

Këndimi prej Letrës së Palit nër Hebrejtë :

Vëllezër, ay që shëntëron dhe atâ që shëntërohen janë prej njëj, për atë shkak nuk i vien turp t' i quaj vëllezër, duke thënë : Do t' lajmëroj emërin tënt nër vëllezërit e mî, në mes të Kishës do t' të hymnoj. Dhe prapë : Unë do të kem besim te ay. Dhe prapë : Ja unë edhe diemtë që më dha Perëndia. Dhe me-qënë-që diemtë piesëtojnë prej mishi dhe prej gjaku, dhe ay përiferisht piesëtoj prej syresh, që me anën e vdekjes t' abolitë atë që ka pushtetin e vdekjes, do-me-thënë Diallin ; dhe t' i çlirojë atâ që ishin fajtorë robërie për tërë jetën e tyre nga frik' e vdekjes. Se nukë merr natyrë prej Engjëjsh, po prej farës së Abraamit. Përandaj detyronte t' u shëmbëllente vëllezërve më të gjitha, që të bëhet Kryepriift mëshirëplot dhe besnik më punët e Perëndisë, që t' i hirësojë mëkatat e popullit ; se

nga që pësoj dhe u-nga vetë, munt t' u ndihmojë të ngarëve.

Alleluia, alleluia, alleluia.

UNGJILLI (PAS JOANIT).

M' atë kohë, u-ngjit Jesuj ndë Jerusalem. Dhe është në Jerusalem një liqen pranë Tregut të Dhënve, që quhet Hebraisht Bethesda, dhe që ka pesë kamare. Nër atô ish shtrirë shumic' e madhe prej të sëmurësh, të verbërish, të çalësh, të fishkurësh, që prisnin lëvizjen e ujit. Se Engjëll zbriste më një kohë në liqen dhe turbullonte ujën; dhe i pari që hynte pas turbullimit të ujit bëhej i shëndoshë prej çfarëdô sëmundjeje që të kishte.

DIAKU me një herë thotë Paqësoret :

Më paqje le t' i lutemi Zotit.

Për paqjen që-lartazi...

Për paqjen e tërë botës...

Për këtë Shtëpi të shëntë...

Për Kryepeshkopin...

Për Presidentin...

Për këtë qytet...

Për temperim të mirë...

Për atâ që lundrëzojnë...

Që të shëntërohet kiô ujë me fuqinë, vepërimin, dhe përmiardhjen e Shpirtit Shënt, le t' i lutemi Zotit.

Që të vinjë mi këtë ujë vepërimi paqësor i Trinisë së përmiqënëshme, le t' i lutemi Zotit.

Që të bëhet kiô ujë shërim shpirtesh e trupesh, dhe largim ç' dô fuqie kundrështare, le t' i lutemi Zotit.

Që të dërgohet mi të hir' i çpërblimit, dhe bekim' i Jordanit, le t' i lutemi Zotit.

Për gjith' atâ që kanë nevojë për ndihmën dhe përkrahjen e Perëndise, le t' i lutemi Zotit.

Që të ndriçohemi me ndriçimin e kupëtimit, me anën e Trinisë së bashkëqënurshme, le t' i lutemi Zotit.

Që të na bëjë Zoti Perëndia jonë bij dhe trashëgimtarë të Mbretërisë së tij, duke piesëtuar e duke u-spërkatur me këtë ujë, le t' i lutemi Zotit.

Që të na shpëtojë prej ç' do hidhërimi...

Përkrah-na, shpëtô-na....

Tërëshënten, të pacinuarën....

PRIFTI me zë të lartë :

Se ty të kahie ç' dô lavdí, nder, e adhurim, Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Pastaj thotë këtë Urim :

Le t' i lutemi Zotit.

O Zot, Perëndia jonë, i madhi në këshillë dhe i çuditshimi në veprat, krijetar' i kriesës së dukur e së padukur ; që ruan testamentin tënt dhe mëshi-

rën tënde mi atâ që të duan dhe mbajnë urdhërimet e tua ; që pret lott' e mëshirëshme t' atyre që ndodhen më shtrëngim ; se përandaj erdhe me fytyrë robi, jo që të na frikësosh me hiera, po nga që dëshëronje shëndet të vërtetë për trupin, duke thënë : Shëkô, u-bëre i shëndoshë, mos mëkatô më ; dhe me baltë shërove sy, dhe duke e urdhëruar t' i lajë, e përgatite me fialë të rrijë në dritë ; ti që trubullon tallazet e pasioneve kundrështare, dhe zbutë detin e kripur të kësaj jete, dhe valat e rënda të dëfrimeve. Ti, ô Mbret njerzidashës, që na dhe të veshim stolî të ndriçime si dëborë prej uji dhe prej shpirti, dërgô-na me piesëtimin dhe spërkatjen e këtij uji bekimin tënt, që shpërllan ndyrësin' e pasioneve. Po, të lutemi : Vështroj-e, ô i Mirë, dobësinë tonë, dhe shërô-na'i sëmundjet e shpirtit dhe të trupit, me mëshirën tënde, me nërmjetimet e Zonjës s' onë së kulluar Hyjlindëses dhe gjithmon-virgjërës Marî ; me fuqin' e kryqit të çëmuar dhe jetëdhënës ; me mprojtjet e Fuqive qiellore të nderuara ; të ndershimit, të lavdëruarit Profet, Parërendës dhe Pagëzor Joan ; t' Apostujve të shëntë, të lavdëruar, dhe emër-shkëlqyer ; t' Atërve tanë ohënarë dhe hyjprurës ; t' Atërve tanë nërmjet Shëntorët, Kryepriiftërve të mëdhej dhe Mësonjësve Ekumenikë, Basilit të Math, Gregorit Theolog, dhe Joan Gojartit ; t' Atërve tanë nërmjet Shëntorët, Athanas dhe Qyrill, Patrikë të Skënderisë ; t' Atit tonë nërmjet Shëntorët Spyridon peshkopit të Trimy-

thuntës, çudibërësit ; t' Atit tonë nërmjet Shëntorët Nikoll, peshkopit të Myrave të Lyqisë, çudibërësit ; të Dëshmorit të math të lavdëruar Shën-Gjergj Tropeprurësit ; të Dëshmorit të Math të lavdëruar Shën-Mitër Myrobletit ; të Hyjprindërve të shëntë e të drejtë Joaqim dhe Anna, të Anargjëndëve të shëntë, të lavdëruar dhe çudibërës, Kosma dhe Damian, Qyr e Joan, Pantelimon dhe Hermola, Samson e Diomed, Moq e Aniqet, Thalele e Tryfon ; të Shënt (aksh) që po lusim sot, dhe të gjithë Shëntorëve tënt. Dhe ruaj-i, ô Zot, shërbëtorët e tû, dhe Presidentin tonë (a po Mbretin,— *Triherë*), fal'u shëndet shpirti dhe trupi, dhe rrëfeh-u i butë për këtë qytet të krishterësh, që po të shërben. Kujtô, ô Zot, ç' dô peshkopí Orthodoxësh, që presin drejtërisht fialën e së vërtetës s' ate, dhe ç' dô urdhër priftëror dhe kllogjëror, dhe shpëtimin e tyre. Kujtô, ô Zot, atâ që na duan e na urrejnë ; vëllezërit tanë që shërbejnë, atâ që rrinë rrotull, dhe atâ që s' ndodhen për shkake t' arësishme, dhe atâ që na porositnë ne të pavyerit të lutemi për tâ. Kujtô, ô Zot, dhe vëllezërit tanë që ndodhen në robëri e nër hidhërimë, dhe mëshiroj-i pas mëshirës s' ate së madhe, duke i shpëtuar prej ç' dô nevoje.

Se ti je burim' i shërimeve, ô Krisht Perëndí, dhe ty të dërgojmë lavdî, bashkë me Atin tënt pa-nisje, dhe shpirtin tënt tërëshënt, të mirë dhe jetëdhënës, taní e përherë, e në jetë të jetëve.

Amen.

Paqje mi ju të gjithë.
Krerët tuaja unjani Zotit.

Dhe thotë këtë Urim fshehtazi :

Unj, ô Zot, veshin tënt, dhe dëgjô-na ne ti që dignove të pagëzohesh në Jordan, dhe shëntërove ujërat; dhe bekô-na të gjithë ne që po të rrëfejmë se jemi robërit tënt duke unjur xverqet tona; dhe vlerësô-na të rrafshohemi prej bekimit tënt, me piesëtimin dhe spërkatjen e këtij uji; e na u-bëftë, ô Zot, për shërim shpirti dhe trupi.

PRIFTI me zë të lartë :

Se ti je shëntërimi ynë, dhe ty të dërgojme lavdi, për hirim, e adhurim, bashkë me Atin tënt pa-nisje, dhe me Shpirtin tënt jetëdhënës, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

Amen.

Pastaj merr Kryqin e çëmuar, bekon ujën për-së-treti, duke e zhytur e duke e ngritur, e duke kënduar :

O Zot, shpëtô popullin tënt dhe bekoj-e trashëgimin tënt; dhuroj'u besëmirëve mundje kundër barbarëve, dhe ruaj-e Shtetin tënt me anën e Kryqit tënt. (Tri herë.)

Pastaj, duke spërkatur kryqthi, thotë këtë Tropar :

TINGËLL II.

Bë-na të vyer për dhuratat tënde, ô Virgjëreshë

Hyjlindëse, pa vënë 're fajet tona dhe fal'u shërim atyre që presin bekimin tënt me besë, ô e Kulluar.

Pastaj Prifti e puth Kryqin dhe gjithë populli dhe i spërkat të gjithë.

VALLEJA këndon këtë Tropar :

TINGËLL IV.

Duke patur burim shërimesh, ô Shënt Anargjëndë, dhuroni shërime tërë atyre që ju luten, si të vlerësuar për dhurata të mëdha prej burimit t' ameshuar të Shpëtimtarit tonë ; se Zoti ju thotë, si të bashkëzellshtë me Apostujtë : Ja tek ju kam dhënë pushtet kundër shpirtesh të ndyrë, që t' i nxirni, e të shëroni ç' dô sëmundje e ç' dô dobësi. Përandaj, duke u-siellë mirë pas urdhërimit e tij, darovisht muartë. darovisht i epni, duke shëruar. pasionet e shpirtëve dhe të trupeve tona.

Lavdi Atit...

Unj-u nër lutjet e shërbëtorëve tënt, ô e Kulluar, duke pushuar kryengritjet e tmerreve tona, e duke na çliruar prej ç' dô hidhërimi ; se ty vetëm kemi ankurë të shigurtë e të palajthitur, dhe kemi patur mprojtjen tënde. Mos u-turpërofshim, ô Zonjë, duke t' u-lutur ; shpejtô në lutjen e atyre që të thërresin me besë ; gëzoh-u, ô Zonjë, ndihma e të gjithëve, gëzimi, mburonja dhe shpëtim' i shpirtëve tona.

Tanî...

O Zonjë, prit lutjet e shërbëtorëve tënt, dhe çpërblë-na prej ç' dô shtrëngimi dhe helmi.

DIAKU :

Mëshirô-na, ô Perëndi...

Të lutemi dhe për mëshirë, jetë,...

PRIFTI :

Dëgjô-na, ô Perëndi, Shpëtimtari ynë, shpresa e gjithë anëve të dheut dhe t' atyre që ndodhen nër detet lark ; dhe i hirëshim, i hirëshim rrëfeh-u, ô Zot i Math, për mëkatat tona dhe mëshirô-na.

Se ti je Perëndi mëshirëplote dhe njerzidashëse, dhe ty të dërgojmë lavdi, Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

Paqje mi ju të gjithë.

Krerët tanë le t' i'a unjim Zotit.

URIM.

O Zot mëshirëplot, Zoti Jesu Krisht, Perëndia jonë, me nërmjetimet e Zonjës s' onë së Pacinuar Hyjlindëses dhe gjithmon-virgjërës Mari ; me fuqin' e Kryqit të çëmuar dhe jetëdhënës ; me mprojtjet e Fuqive qiellore të nderuara ; të nderçimit dhe të lavdëruarit Profet, Parërendës, dhe Pagëzor Joan ; të Dëshmorëve të shëntë, të lavdëruar, dhe bukur-mundës ; t' Atërve tanë oshënarë dhe hyjprurës ; të Hyjprindërve të shëntë e të drejtë Joaqim dhe Anna, dhe të gjithë Shëntorëve tënt ; prit-e mirë lutjen tonë ; dhurô-na ndjesën e fajeve tona ; mbulô-na nënë hien e krahëve tënt ; dbô prej nesh ç' do armik dhe kundrështar ; paqësô-na-e jetën O Zot, mëshirô-na ne dhe botën tënde, dhe shpëtoj-i shpirtet tona, si i mirë dhe njerzidashës.

PËRLËSHIM.